



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije - Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation
Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve

Datë: 03.12.2023

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM) në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 13/2023 për KSHLM, Neni 5, paragrafi 5.1., si dhe duke u bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 14/2023 për Sistemin e licencimit dhe karrierën në mësimdhënie, Nenin 8 dhe Nenin 11 të këtij UA, për rregullimet e Licencës së avancuar për mësimdhënie, bën:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR

LICENCËN E AVANCUAR PËR MËSIMDHËNIE

Konteksti

MASHTI, bazuar në politikat arsimore për Sistemin e Licencimit të Mësimdhënësve, si dhe në bazë të përgjegjësive që ka për këtë proces, hap thirrje për aplikim për mësimdhënësit që i plotësojnë kushtet dhe kriteret, dhe synojnë të marrin Licencën e Avancuar për Mësimdhënie duke u bazuar në UA-14/2023.

Kjo është thirrja e parë publike që MASHTI e bën për mësuesit/mësimdhënësit e shkollave publike në Kosovë. Thirrja e parë bëhet për mësuesit/mësimdhënësit e profileve si më poshtë:

1. Mësues të arsimit fillor;
2. Mësimdhënës të lëndës “Matematikë” në Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU) dhe Arsimin e Mesëm të Lartë (AML); dhe
3. Mësimdhënës të lëndës “Gjuhë shqipe” në Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU) dhe Arsimin e Mesëm të Lartë (AML);

Kushtet për aplikim

Për të aplikuar për Licencë të Avancuar për Mësimdhënie, mësuesi/mësimdhënësi/ja duhet:

- Të ketë së paku **8 vite përvojë pune me licencë të karrierës**;
- Të ketë të përtrirë licencën e karrierës në bazë të njërit nga raportet në vijim:
 - (i) Raportit të vlerësimit/vendimit të lëshuar nga Inspektorati i Arsimit për përtrirjen e licencës së karriereës;
 - (ii) Raportit të vlerësimit të brendshëm të performancës të lëshuar nga shkolla sipas procedurave të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 15/2023, datë 16/06/2023.
- Të ketë arritur së paku **200 orë zhvillim profesional (ZhP), nga viti shkollor 2016-2017 dhe deri me datën e aplikimit për licencë të avancuar** (*prej 200 orëve akumulative të ZHP, 50% mund të jenë nga programet e miratuar nga KSHLM dhe 50% nga trajnimet dhe aktivitetet e Zhvillimit Profesional me Bazë në Shkollën (ZhPMBSH)*)

Shënim lidhur me orët e zhvillimit profesional: Nëse një aplikant nuk ka orë të mjaftueshme të kërkuara nga ZhPMBSH, por ka orë të ZhP nga programet e akredituara/aprovuara, të mjaftueshme për kërkesat për Licencë të Avancuar, ato njihen në sistemin e aplikimit për Licencë të Avancuar.

Dokumentet – të dhënat për aplikim

Të gjitha dokumentet dhe të dhënat për aplikim janë të specifikuara në **platformen e-Kosova** në linkun e aplikimit për Licencë të Avancuar për Mësimdhënie: <https://ekosova.rks-gov.net/539>. Aplikanti duhet të plotësoj:

- Të dhënat personale
- Të dhënat mbi arsimin – kualifikimin
- Të dhënat mbi trajnimin – zhvillimin profesional
- Të dhënat mbi punësimin
- Licensë e mësimdhënësit – licensë e karrierës e përtrirë

Shënim: Dokumentet e kompletuara të ngarkuara në platformën e-Kosova, mundësojnë aprovimin e aplikimit dhe nisjen e procedurave për realizim të procesit të vlerësimit për Licencën e Avancuar për Mësimdhënie.

Dorëzimi i aplikimit

I gjithë procesi i aplikimit bëhet në platformën e-Kosova ose aplikimi në kopje fizike. Dokumentacioni i kompletuar për aplikim ngarkohet në këtë platformë - në linkun e aplikimit për Licencë të Avancuar për Mësimdhënie: <https://ekosova.rks-gov.net/539>. Kandidatet të cilët dëshirojnë të aplikojnë me **dokumentacion në kopje fizike**, dokumentacionin e kompletuar e dërgojnë në **MASHTI, kati i dytë Nr. 202**.

Afati për aplikim

Aplikimi mund të bëhet nga data **04.12.2024 deri me datë 19.12.2024**

Bazuar në aplikimet e mësimeve në bazë të thirrjes publike për aplikim, MASHTI përgatit listën e mësimeve që kanë aplikuar dhe e organizon provimin kualifikues për mësime të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët për të ndjekur procedurat e vlerësimit për avancim.

Për datën dhe vendin e mbajtjes së provimit kualifikues për licencë të avancuar për mësime, mësuesit/mësimeve informohen me kohë nga personi përgjegjës në MASHTI.

Informacione të rëndësishme për mësime të cilët aplikojnë në thirrjen për marrje të Licencës së avancuar për mësime

Politikat arsimore për Sistemin e licencimit dhe Vlerësimin e performancës së mësimeve që përcaktojnë kërkesat dhe kriteret e marrjes së Licencës së Avancuar për Mësime janë:

- **Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimeve në Kosovë (KSZHM)**
<https://masht.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/05/kornize-strategjike.pdf>
- **Udhëzimi Administrativ 14/2023 për Sistemin e licencimit dhe karrierën në mësime;** <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-14-2023-per-sistemin-e-licencimit-dhe-karrieren-ne-mesime/>
- **Udhëzimi Administrativ 15/2023 për Vlerësimin e performancës së mësimeve;** <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-15-2023-per-vleresimin-e-performances-se-mesimeve/>
- **Udhëzimi Administrativ 16/2023 për Zhvillimin profesional të mësimeve;** <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-16-2023-per-zhvillimin-profesional-te-mesimeve/>

Provimin kualifikues për licencë të avancuar për mësime

Organizohet në fushat e zhvillimit profesional më poshtë:

Fushat e zhvillimit profesional	Shpërndarja e kërkesave/pyetjeve të provimit në % - sipas fushave të ZHP
Dokumentacioni zyrtar shkollor	Rreth 6%
Kurrikula - Programi lëndor	Rreth 9%
Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë	Rreth 18%
Aspekte të gjithëpërfshirjes dhe etika në profesion	Rreth 4%
Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Rreth 6%
Përmbajtja shkencore e lëndës e lidhur me kurrikulën e nivelit të arsimit ku mësimeve/ja punon	Rreth 57%
Totali	(100%)

Vlerësimi nga Inspektorati i Arsimit

Kandidatët që i arrijnë me sukses pikët e provimit të kualifikimit të organizuar nga MASHTI, iu nënshtrohen vlerësimit të performancës nga Inspektorati i Arsimit (IA). Vlerësimi nga IA përfshin:

- i. Vlerësimin e portfolios profesionale (rreth 42%); dhe
- ii. Vëzhgimin në klasë – Vlerësimin e orës mësimore (rreth 58%).

Mësimdhënësit nga procesi i avancimit përfitojnë rritjen për punën meritore që bëjnë, duke u përfshirë në ngritje të pagës në bazë të koeficientit të përcaktuar sipas Rregullores (QRK) nr. 01/2023 për shtesën për licencë të avancuar për nëpunësin e arsimit parauniversitar.

Koeficienti i ngritjes në pagë për mësimdhënësit që marrin licencë të avancuar është 1.2. Ky koeficient i shtohet koeficientit bazë të pagës së mësimdhënësve me Licencë të karrierës.

Programet e zhvillimit profesional dhe udhëzuesi për licencë të avancuar

MASHTI, me qëllim të mbështetjes e mësimdhënësve që aplikojnë për marrje të Licencës së Avancuar për Mësimdhënie, ka zhvilluar tri programe të zhvillimit profesional dhe një udhëzues të përgjithshëm për licencë të avancuar:

1. Programi i zhvillimit profesional për marrjen e Licencës së Avancuar për Mësues të arsimit fillor;
2. Programi i zhvillimit profesional për marrjen e Licencës së Avancuar për mësimdhënësit të lëndës “Gjuhë shqipe”;
3. Programi i zhvillimit profesional për marrjen e Licencës së Avancuar për mësimdhënësit të lëndës “Matematikë”; dhe
4. Vlerësimi për licencë të avancuar - Udhëzues për mësimdhënësit.

Detajet e udhëzimeve për provimin e kualifikimit dhe për vlerësimin nga Inspektorati i Arsimit, mund ti gjeni në programet e zhvillimit profesional dhe udhëzuesin e përgjithshëm për licencë të avancuar, të publikuar në faqën zyrtare të MASHT-it, në linkun:

<https://masht.rks-gov.net/programet-e-zhvillimit-profesional-dhe-udhezuesi-per-licence-te-avancuar/>

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: [+383213171](tel:+383213171) ose në email adresën: osman.beka@rks-gov.net;